
6

Kush është Jezusi për ne?

Meqenëse punoj si profesor në universitet, jam vazhdimisht i zënë me ndonjë lloj kërkimi shkencor. Gjithashtu, unë shpesh u jap studentëve të mi projekte për të bërë. Duhet ta pranoj se studentët e mi jo gjithmonë i pëlqejnë këto lloj detyrash. Ndoshta dy janë arsyet pse atyre nuk u pëlqejnë ato. E para, kërkimi i materialeve shpesh është punë e rëndë. Dikush ka thënë: «Mua nuk më pëlqen të lexoj, por do të më pëlqente të kisha lexuar shumë libra.» Studentëve të mi nuk u pëlqen të lexojnë shumë libra për të gjetur përgjigjet e pyetjeve të kërkuara në projekt. Por nga ana tjetër ata duan t'i dinë ato përgjigje. E dyta, shumë kërkime janë pa fund, ato kurrë s'mbarojnë. Kërkimi na bën të kuptojmë çfarë dimë dhe çfarë nuk dimë dhe, disa herë, çfarë nuk njohim është më e dukshme se ajo që njohim. Një student mund ta përfundojë pa problem një projekt kërkimi duke thënë: «Përpara se të filloja këtë projekt kërkimi, nuk dija ndonjë gjë në këtë fushë. Tani që e përfundova projektin, mësova se asnjë nuk di ndonjë gjë në këtë fushë!» Një përfundim i tillë mund të jetë shumë zhgënjyes.

Të gjithë ne duam të njohim të vërtetën për atë që është

e rëndësishme. Kjo është në mënyrë të veçantë e vërtetë, kur diskutojmë për Jezu Krishtin. Nuk duhet të dëgjojmë opinionin e ndokujt apo një diskutim teorish të paqarta për Të. Duhet të njohim të vërtetën për Të. Pyetjet tona më serioze për Të janë konkrete dhe me vend: Kush është Jezusi? A është Ai me të vërtetë Biri i Perëndisë? Çfarë thotë Ai për jetën dhe shpëtimin?

Bibla është i vetmi libër i saktë në botë. Perëndia na e dha atë që të mund të njohim mësimet e Tij (2 Pjetër 1:3). Perëndia nuk do që ne ta kalojmë jetën pa marrë ndonjë vendim përfundimtar për Jezusin. Ai do që ne të mësojmë se kush është Jezusi dhe cili është qëllimi i ardhjes së Tij. Ai do që ne të njohim të vërtetën për Të, në mënyrë që të mund ta ndërtojmë jetën tonë me siguri dhe besim mbi këtë të vërtetë.

Bibla na jep të vetmin përshkrim të vërtetë që kemi për Jezusin. Ajo na tregon se kush është Ai në dy mënyra: E para, ne kuptojmë se kush është Ai duke parë emrat me të cilët Ai është thirrur në Bibël. E dyta, ne kuptojmë se kush është Ai duke parë *karakteristikat* e Tij, të gjendura në Bibël.

Le të shikojmë me vëmendje se si është quajtur Ai në Bibël. Në qoftë se dikush na është prezantuar si murator apo mësues nga një njeri i besuar, atëhere e dimë se kush është ai njeri dhe çfarë njeriu është. Termat «murator» dhe «mësues» na japin një përshkrim të veçantë për Të.

Bibla na e bën të qartë identitetin e Jezusit. Ai është përshkruar në mënyrë të veçantë me terma që nuk mund të keqkuptohen. Duke studiuar me kujdes emrat e përdorur për Jezusin në Bibël, ne mësojmë se kush është Ai.

JEZUSI ËSHTË SHPËTIMTARI YNË

E para, Shkrimet e quajnë Jezusin «Shpëtimtar». Fjala «shpëtimtar» tregon dikë që shpëton të tjerët nga një rrezik i madh.

Në tregimin e lindjes së Jezusit, në librin e Mateut përmendet një engjëll që iu shfaq në ëndërr Jozefit, babait të ardhshëm të Jezusit. Engjëlli i tha:

...«Jozef, biri i Davidit, mos ki frikë ta marrësh me vete Marinë si gruan tënde, sepse ç'është mbarsur në të është vepër e Frymës së Shenjtë. Dhe ajo do të lindë një djalë dhe ti do t'i vësh emrin Jezus, sepse Ai do të shpëtojë popullin e Tij nga mëkatet e tyre» (Mateu 1:20–21).

Siç e shikoni, Jezusi nuk do të bëhej një shpëtimtar çfarëdo; Ai erdhi për t'u bërë një Shpëtimtar unik. Në qoftë se një njeri shpëton një fëmijë në një ndërtesë që digjet, ne e quajmë atë shpëtimtar. Në qoftë se një njeri u shpërndan ushqime njerëzve që po vdesin urie, ai quhet shpëtimtari i tyre. Jezusi, sipas Shkrimeve, na shpëton nga mëkatet tona. Ai është Shpëtimtari ynë shpirtëror.

Çdo person i përgjegjshëm duhet ta konsiderojë fajin e mëkatit si të keqen numër një. Francis A. Schaeffer ka thënë se në qoftë se do të inçizonim çdo fjalë që del nga gojët tona për dyzet e tetë orë, shumë lehtë do të kuptonim se jemi mëkatarë. Në qoftë se do të uleshim dhe do të dëgjonim çdo fjalë, të mendonim për motivin pas çdo thënieje dhe të vërenim tonin me të cilin folëm, natyrisht do të arrinim në përfundimin se jo gjithmonë themi atë që duhet të kishim thënë. Në të njëjtën mënyrë, mund të përdorim një kamera për të regjistruar dyzet e tetë orë nga jeta jonë. Po të shikonim çdo veprim tonin, me shumë lehtësi do të kuptonim se jemi mëkatarë. Ne do të tronditemi nga e vërteta se shpesh bëjmë atë që nuk duhet bërë dhe shpesh nuk bëjmë atë që duhet të bëjmë. Schaeffer thotë se ne madje nuk kemi nevojë për Biblën të na tregojë se jemi mëkatarë. Kur shikojmë nga afër fjalët dhe veprat tona, e kuptojmë se jemi mëkatarë. Bibla, sidoqoftë, e deklaroi këtë të vërtetë me një gjuhë të qartë. Pali u kujton kristianëve: «Nuk ka asnjëri të drejtë, as edhe një» (Romakëve 3:10).

Çfarë mund të bëhet për mëkatin tonë? Ne nuk mund të falim vetveten. Mëkati ynë nuk është vetëm kundër të tjerëve, por gjithashtu është kundër Perëndisë. Kush mund të na ndihmojë të zgjidhim këtë problem shumë urgjent? Asgjë dhe asnjë nuk mund të na falë mëkatet. Pretendimi se nuk jemi mëkatarë është një gënjeshtër dhe nuk do të na shpëtojë. Çfarë mund të bëhet? Përgjigjja e Perëndisë për situatën tonë të dëshpëruar është Jezusi. Jozefit iu tha se emri i Jezusit ishte përcaktuar që në qiell për arsye të funksionit që Ai do të plotësonte në tokë. Me lindjen e Tij, engjëlli njoftoi barinjtë në një kodër në Palestinë: «Sepse sot në qytetin e Davidit lindi për ju një Shpëtimtar, që është Krishti, Zoti» (Lluka 2:11). Qëllimi kryesor i ardhjes së Jezusit në këtë tokë ishte të na shpëtonte nga mëkatet tona (1 Korintasve 15:3).

Kam dëgjuar një histori prekëse të një ushtari në ushtrinë e Napoleonit. Ai kishte qenë një ushtar besnik dhe trim. Midis betejave, ai shkante në tendë për t'u kujdesur për detyrimet e tij dhe problemet familjare. Ai kishte shkruar në një copë letër borxhet që kishte dhe paratë që i duheshin për t'u kujdesur për familjen e tij. Një ndjenjë zhgënjimi e përpiu kur kuptoi se nuk kishte paratë e nevojshme për borxhet dhe shpenzimet e familjes së tij. I shqetësuar shumë, ai shkroi në fund të fletës ku kishte rreshtuar borxhet e tij: «Kush është në gjendje të paguajë gjithë këto borxhe?» Duke u ndier i mundur, uli kokën mbi gjunjë dhe fjeti. Pa dijeninë e ushtarëve, Napoleoni po kontrollonte përmes kampit të ushtarëve, për të shikuar kushtet dhe gadishmërinë e tyre. Kur po kalonte afër tendës së ushtarit të ri, ai urdhëroi të inspektohej, por asnjë përgjigje nuk erdhi nga brenda tendës. Ai hyri brenda dhe vështroi. Ai pa ushtarin që po flinte dhe pyetjen prekëse të shkruar në fund të fletës. Napoleoni u përkul, mori penën e tij dhe shkroi poshtë pyetjes: «Unë do t'i paguaj» dhe pastaj vuri firmën: «Napoleoni».

Kur shikojmë borxhin tonë të mëkatit dhe nevojën tonë të madhe për shpëtim, ne thërrasim: «Kush mund t’i paguajë gjithë këto borxhe?» Dikush shumë më i madh se Napoleoni është përgjigjur: «Unë do t’i paguaj.» Jezusi, Shpëtimtari i botës, me vdekjen e Tij në kryq, na ka ofruar shpëtimin e plotë.

Bibla është e qartë se Jezusi është shpëtimtari ynë i vetëm. Pjetri u deklaroi pushtetarëve hebrenj: «Vetëm Jezusi, Mesia, mund t’ju sjellë shpëtim, sepse nuk ka asnjë tjetër, nëpërmjet të cilit mund të shpëtojmë» (Veprat 4:12). Në qoftë se doni të shpëtoheni nga mëkatet tuaja për t’u pranuar nga Perëndia, duhet të vini te Krishti (Gjoni 14:6; Marku 16:16). Sipas Biblës, Ai është Shpëtimtari ynë.

JEZUSI ËSHTË KRISHTI

E dyta, Jezusi është quajtur «Krishti», që në shqip do të thotë «i zgjedhuri». Fjala «Krisht» në gjuhën greke është e njëjtë me fjalën «Mesia» në gjuhën hebraike. Testamenti i Ri e përshkruan Jezusin si të premtuarin e Perëndisë, si të Zgjedhurin nga Perëndia vetë.

Profetët kishin paralajmëruar se një shërbëtor i veçantë i Perëndisë po vinte. Isaia shkroi:

Sepse na ka lindur një fëmijë, një djalë na është dhënë. Dhe Ai do të jetë sundimtari ynë. Ai do të quhet Këshilltar i urtë, Perëndi i fuqishëm, Atë i përjetshëm, sundimtar paqepurës. Mbretërimi i Tij do të shtrihet gjithandej dhe do të zotërojë paqja e qëndrueshme. Ai do të mbretërojë si trashëgimtar i fronit të Davidit dhe sundimi i Tij do të qëndrojë përgjithmonë, duke u bazuar në drejtësinë e Perëndisë. Perëndia i gjithëpushtetshëm vendosi kështu, dhe do ta realizojë këtë (Isaia 9:6-7).

Mikea profetizoi: «Por ti, o Betlehem Efratah, megjithëse je i vogël midis mijërave të Judës, nga ti do të dalë për mua Ai që do të jetë sundues në Izrael, origjinat e të cilit janë nga kohërat e lashta, nga ditët e përjetësisë» (Mikea

5:2). Testamenti i Ri vërteton se këto profeci kishin të bënin me ardhjen e Jezusit.

Nga fundi i misionit të Tij në tokë, Jezusi po ecte me dishepujt e Tij drejt Çezarea Filipit. Ndërsa po ecnin, Jezusi pyeti dishepujt e Tij: «Kush thonë njerëzit se jam Unë, i Biri i Njeriut?» Dishepujt e Tij thanë: «Disa thonë Gjon Pagëzori; të tjerët Elia, të tjerë Jeremia, ose një nga profetët» (Mateu 16:13–14). Pas përgjigjes së dishepujve, e përfytyroj Jezusin të ndalojë dhe të shikojë drejt e në sy dishepujt e Tij duke i pyetur: «Po ju, kush thoni se Unë jam?» Pjetri u përgjigj: «Ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë» (Mateu 16:15–16). Jezusi përgëzoi Pjetrin për përgjigjen e tij: «I bekuar qofsh ti, o Simon, bir i Jonas, sepse këtë nuk ta zbuloi as mishi as gjaku, por Ati Im që është në qiell» (Mateu 16:17). Me fjalë të tjera Jezusi po thoshte: «Pjetër, ti nuk arrite në këtë përfundim i bazuar mbi ato që njerëzit kanë thënë. Ti e ke marrë këtë përgjigje nga Perëndia në qiell.» Ky ishte një zbulim hyjnor dhe jo një shpikje njerëzore.

Disa vite më parë, një ish president amerikan vizitoi universitetin Harding, ku unë jap mësim. Në ditën e ardhjes së tij, i gjithë ambjenti ishte mbushur me gëzimin për vizitën e tij. Unë dhe gruaja ime, Suzana, së bashku me fëmijët shkuam në sallë herët, që të mund të gjenim vende të mira. Fatmirësisht, ne patëm mundësi të uleshim në radhët e para, vetëm pak metra larg podiumit ku ish presidenti do të fliste. Kur ai po shkonte drejt podiumit dhe banda po luante himnin e rastit, pjesëmarrësit e shumë shpërthyen në duartrokitje për rreth 5 minuta. Ishte një moment që unë do ta kujtoj gjithmonë. Dhe mendoja: «Ky është pikërisht njeriu që ka patur pozitën më të lartë në vendin tonë për tetë vjet. Ai nuk ishte pothuajse i pari; ai ishte i pari!»

Mendo se si Testamenti i Ri i referohet Jezusit. Kur e quan Atë «Krishti», e identifikon si të vetmin, të zgjedhurin

e veçantë të Perëndisë. Ai nuk është pararendës i ndonjë të zgjedhuri, Ai vetë është i Zgjedhuri. Ai nuk predikoi ardhjen e të Zgjedhurit, Ai vetë ishte përmbushja e gjithë profecive për të Zgjedhurin. Ai nuk ishte thjesht i shoqëruar me të Zgjedhurin, por Ai ishte vetë i Zgjedhuri.

JEZUSI ËSHTË BIRI I PERËNDISË

E treta, Jezusi është identifikuar në Testamentin e Ri si Biri i Perëndisë, anëtari i dytë i Hyjnisë.

Gjon Pagëzori ishte zgjedhur nga Perëndia për të përgatitur rrugën për misionin e Jezusit në tokë. Ai e bëri këtë punë duke predikuar pendesën dhe duke pagëzuar për faljen e mëkateve (Marku 1:4). Gjoni i drejtoi njerëzit që iu përgjigjën predikimit të tij drejt Mesisë që pritej të vinte. Me pendimin dhe pagëzimin e tyre, njerëzit po betoheshin që ta pranonin Mesinë, kur Ai të vinte (Veprat 19:4). Pasi Gjoni përmbushi misionin që Perëndia i kishte dhënë, gjithë Judea dhe gjithë zonat rreth Jordanit shkuan dhe u pagëzuan prej tij (Mateu 3:5). Një ditë, kur Gjoni po pagëzonte njerëzit në lumë, Jezusi u shfaq në brigjet e lumit Jordan. E imagjinoj se, pasi Gjoni kishte mbaruar së pagëzuar dikë, Jezusi i tha atij: «Tani është radha Ime për t’u pagëzuar.» Gjoni, në këtë kohë, nuk e dinte me siguri se Jezusi ishte Mesia (Gjoni 1:29–31), por e dinte se Jezusi ishte njeri më i mirë se ai. Për shkak të kësaj, Ai iu përgjigj kërkesës së Jezusit duke thënë, në fakt: «Mua më duhet të pagëzohem prej teje, dhe Ti po vjen tek unë?» Jezusi tha: «Lejo të bëhet për tani, sepse në këtë mënyrë përmbushim çdo drejtësi» (Mateu 3:15). Gjoni po bënte punën e Perëndisë. Ai ishte njeri i dërguar nga Perëndia. Jezusi dëshiroi që t’i nënshtrohej tërësisht vullnetit të Perëndisë, gjatë kohës që ishte në tokë. Kështu, Ai me bindje u pagëzua nga Gjoni, jo se Ai kishte mëkate që duheshin falur, jo se kishte nevojë për pendim dhe jo se Ai kishte nevojë që të pranonte Mesinë, kur të vinte. Ai ishte Mesia

dhe u pagëzua prej Gjonit, për të përmbushur vullnetin e Perëndisë.

Kur Gjoni ngriti Jezusin sipër ujit pas zhytjes (së pagëzimit), Fryma e Perëndisë zbriti tek Ai në formën e pëllumbit. Kur Gjoni pa këtë mrekulli, ai e kuptoi se Jezusi ishte Mesia (Gjoni 1:32–34). Pastaj, një zë nga qielli, vetë zëri i Perëndisë foli, duke thënë: «Ky është Biri im i dashur, me të cilin jam shumë i kënaqur» (Mateu 3:17). Vetë Perëndia dëshmon se Jezusi është Biri i Tij.

Sipas apostullit Gjon, na janë dhënë tre dëshmi që Jezusi është Biri i Perëndisë. Ai shkroi: «Dhe tre janë ata që dëshmojnë mbi dhe: Fryma, uji dhe gjaku; dhe këta të tre janë të një mendimi» (1 Gjon 5:8). Fryma e Shenjtë dëshmoi se Jezusi është Bir i Perëndisë, kur zbriti mbi Të në formën e pëllumbit, pas pagëzimit të Jezusit. Fryma e Shenjtë gjithashtu dëshmoi herë të tjera të njëjtën gjë te ungjijtë. «Uji» i referohet pagëzimit të Jezusit, kur Ati deklaroi nga qielli se Jezusi është Biri i Tij. «Gjaku» të cilit i referohet Gjoni duhet të prezantojë vdekjen e Jezusit. Ngjarjet e mrekullueshme që ndodhën gjatë kryqëzimit të Jezusit dëshmojnë për hyjninë e Tij. Gjoni tha: «Në qoftë se ne pranojmë dëshminë e njerëzve, dëshmia e Perëndisë është më e madhe, sepse kjo është dëshmia që Perëndia dha për Birin e Tij» (1 Gjon 5:9). Në qoftë se tre njerëz të ndershëm janë bashkuar për të dëshmuar një të vërtetë të caktuar, ne do të pranojmë dëshminë e tyre dhe kështu do të bënte çdo gjykatë normalisht. Akoma më shumë duhet ta pranojmë dëshminë e Perëndisë! Ai ka dëshmuar për Birin e Tij me anë të Frymës (në formën e pëllumbit në pagëzimin e Tij); me anë të ujit (zëri i Atit u dëgjua në pagëzimin e Tij) dhe me anë të gjakut (mrekullitë që ndodhën në momentin që Jezusi vdiq).

Kush është Jezusi? Shkrimet nuk lënë ndonjë dyshim për përgjigjen. Testamenti i Ri qartësisht thotë se Jezusi është Biri i Perëndisë. Kjo do të thotë se Jezusi s' mund të

mohohet. Që të mohosh Jezusin, do të thotë të mohosh Perëndinë.

JEZUSI ËSHTË ZOT

Së katërti, Testamenti i Ri e quan Jezusin «Zot». Ai është udhëheqësi ynë i lartë, me gjithë autoritetin nga Perëndia.

Pas ringjalljes, Jezusi iu shfaq dishepujve të Tij, duke provuar se u ngrit me të vërtetë nga vdekja. Jezusi u tha dishepujve të Tij:

Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që Unë ju kam urdhëruar. Dhe ja, Unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës (Mateu 28:18–20).

Dhjetë ditë pas ngjitjes së Jezusit tek Ati, apostujt morën Frymën e Shenjtë nga Perëndia. Në atë ditë, Ditën e Rrëshajëve, Pjetri foli përpara një turme të madhe që ishte mbledhur në tempullin e Jeruzalemit. Ai dha dëshmi që provojnë se Jezusi është Krishti. Kur arriti kulmin e predikimit të tij, ai deklaroi: «Ta dijë pra gjithë shtëpia e Izraelit se atë Jezus që ju keni kryqëzuar, Perëndia e ka bërë Zot dhe Krisht» (Veprat 2:36). Pali, pasi përshkruan mënyrën se si Jezusi përuli veten e Tij për t' u bërë njeri dhe si iu bind Atit deri në vdekje, shkroi:

Prandaj edhe Perëndia e lartësoi madhërisht dhe i dha një emër që është përmbi çdo emër, që në emër të Jezusit të përkulet çdo gju i krijesave (ose gjërave) qiellore, tokësore dhe nëntokësore, dhe çdo gjuhë të rrëfejë se Jezu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë At (Filipianëve 2:9–11).

Pali shkroi për Jezusin: «Dhe Ai [Perëndia] vuri çdo gjë nën këmbët e Tij, edhe ia dha për krye përmbi çdo gjë

kishës, e cila është trupi i Tij, plotësia e Atij që mbush çdo gjë në të gjithë» (Efesianëve 1:22–23).

Testamenti i Ri thotë se Jezusi është Zot. Ç’do të thotë kjo? Praktikisht do të thotë se duhet t’i nënshtrohemi Jezusit. Jezusi tha: «Pse më thërrisni, “Zot, Zot” dhe nuk bëni atë që ju them?» (Lluka 6:46). Më tej tha: «Jo çdo njeri që më thotë: “Zot, Zot” do të hyjë në mbretërinë e qiejve; por do të hyjë ai që kryen vullnetin e Atit Tim që është në qiej» (Mateu 7:21). A jeni të gatshëm t’i nënshtroheni mësimëve të Krishtit? E dyta, kjo do të thotë se duhet të vëmë Krishtin të parin në jetën tonë. Duhet t’i japim Atij besnikërinë dhe dashurinë tonë. Ai është Zoti i vetëm i nderuar nga qielli dhe Ai duhet të jetë Zoti i vetëm që duhet të mbretërojë në zemrat tona.

Dikush ka thënë: «Në çdo zemër, ndodhet një kryq dhe një fron. Në qoftë se vendos veten time në fron, unë duhet të vendos Krishtin në kryq. Në qoftë se vendos Krishtin në fron, duhet të vendos veten në kryq.» Asnjëri s’mund të ketë dy zota. Në qoftë se dy djem do të hipin në të njëjtin kalë, vetëm njëri duhet të ulet përpara për ta drejtuar kalin. Në qoftë se dy njerëz udhëtojnë në të njëjtën makinë, vetëm njëri duhet ta drejtojë. Në qoftë se i thoni «po» Krishtit Zot, duhet t’u thoni «jo» dëshirave dhe vullnetit tuaj. Asnjëri nuk mund t’u shërbejë dy zotërinjve, sepse ose do të urrejë njërin, ose do ta dojë tjetrin (Mateu 6:24).

Testamenti i Ri thotë se Jezusi është Zot. Perëndia ka vendosur çdo gjë nën këmbët e Tij. Ai është Mbret i mbretërve dhe Zot i zotave.

KONKLZIONI

Atëhere, kush është Jezusi? I vetmi libër i saktë në botë thotë se Ai është Shpëtimtari ynë, Krishti, i Zgjedhuri i Perëndisë, Biri i Perëndisë dhe Zoti ynë. Kjo është e vërteta për Të. Nuk keni pse të prisni për «ndonjë zbulim tjetër» që të njhni me siguri se kush është Ai. Bibla na tregon të

vërtetën absolute për Të.

Ardhja e Jezusit në botë ndau kalendarin në «p. e. r.» (para erës së re, domethënë përpara Krishtit) dhe «e. r.» (i erës së re, domethënë mbas [vdekjes së] Krishtit). Mateu 25:31–46 thotë se Ai do të ndajë racën njerëzore, të shpëtuarit nga jo të shpëtuarit. Guvernatori romak që gjykoji Jezusin, Pilati, mendoi se Jezusi po qëndronte përpara tij për gjykim, por në realitet Pilati po qëndronte përpara Jezusit. Në ditën e fundit të botës, të shpëtuarit do të përgëzohen nga Jezusi për dedikimin e tyre, kurse jobesimtarët do të marrin dënimin e përjetshëm. Mënyra se si ju i përgjigjeni Jezusit do të vendosë nëse ju do të shpëtoheni apo dënoheni. Mund të shpëtoheni, nëse pranoni shpëtimin që ofron Jezusi. Ai tha: «Unë jam rruga, e vërteta dhe jeta; askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje» (Gjoni 14:6). Ju ose do të vini te Perëndia përmes Jezusit, ose do të provoni shkatërrimin e përjetshëm. Ai erdhi që ne të mund të kemi jetë (Gjoni 10:10); pa Të mbetemi në vdekjen e përjetshme.

Jezusi duke qenë Zot, na fton që të shkojmë tek Ai për shpëtim. Mësues të tjerë fetarë ju ftojnë që të shkoni pas mësimeve të tyre. Por vetëm Jezusi, Biri i Perëndisë, mund t’ju ftojë të shkoni tek Ai. Ai tha: «Ejani tek Unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe Unë do t’ju jap çlodhje» (Mateu 11:28). Ju mund t’i bindeni ungjillit (1 Korintasve 15:1–4; 2 Thesalonikasve 1:6–8) përmes besimit tek Ai (Romakëve 10:17), pendimit për mëkatet tuaja (Veprat 17:30), pranimit të Krishtit si birin e Perëndisë (Romakëve 10:10) dhe pagëzimit në të (Veprat 2:38; Romakëve 6:3). Vetëm kur të vini tek Ai mund të keni jetën e përjetshme.

PËRGJIGJUNI PYETJEVE

(përgjigjet në mësimin “Shtojca 1”)

1. Cili është kuptimi i fjalës «Shpëtimtar»?
2. Pse themi që Jezusi është Shpëtimtari i vetëm?

3. Cili është kuptimi i fjalës «Krisht»?
4. Si e dimë se Jezusi është Biri i Perëndisë?
5. Kujt i referohet Fryma, uji dhe gjaku tek 1 Gjon 5:7–8?
6. Çfarë u deklaroi Pjetri dëgjuesve të tij te Veprat 2?
7. Çfarë do të thotë për ne, praktikisht, që Jezusi është Zot?

FJALË NDIHMËSE

kryqëzimi – vdekja me gozhdim në kryq, një mënyrë romake për ekzekutim. Jezusi, edhe pse i pafajshëm, u kryqëzua për mëkatet tona.

Mesia – «I Vajosuri», Krishti. Testamenti i Ri e identifikon Jezusin si të Bekuarin, apo të Zgjedhurin e Perëndisë.

mishërimi – shfaqja e Birit të Perëndisë në trupin njerëzor, ardhja e Jezusit në tokë për të jetuar si një qenie njerëzore.

ngjitja lart – të shkuarit apo të ngriturit lart. Ngjitja lart ishte ngjarja kur Krishti, pasi u ringjall nga vdekja, u rimor lart në qiell për të qenë me Perëndinë.

paraekzistenca – të qenit gjallë përpara krijimit të botës. Kjo natyrë i përket vetëm Perëndisë (Perëndisë At, Perëndisë Bir dhe Perëndisë Frymë e Shenjtë). Jezusi ekzistonte përpara se të bëhej njeri. Ai është një qenie e përjetshme që gjithmonë ka qenë, që është dhe gjithmonë do të jetë. (Shikoni Gjoni 1:1–11.)

pendimi – akti i ndryshimit në mënyrën e të menduarit të dikujt që sjell si rezultat ndryshimin e mënyrës së jetesës.

qyteti i Davidit – Betlehem. Në Bibël, Betlehem shpesh është përmendur si «qyteti i Davidit».

ringjallja – ngritja e një të vdekuri përsëri në jetë. Ringjallja (ngjarja e ngritjes së Jezusit nga vdekja) është prova se Jezusi ka fuqi mbi vdekjen dhe ata që e ndjekin Atë, do të jenë në gjendje të jetojnë përjetë me Të në qiell, pas jetës së tyre në tokë.

rrëfim – pohimi i besimit të dikujt te Jezu Krishti si Biri i Perëndisë, dhe pranimi i Tij si Zot dhe Shpëtimtar. (Shikoni Veprat 8:37; 1 Timoteut 6:12.)

Autor: *Eddi Cloer*

Marrë nga libri: “*Si të bëhesh një kristian besnik*”

© 2003 E VERTETA PER SOT

Të gjitha të drejtat të rezervuara